

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
Departamenti i Gjeografisë
Programi: gjeografi master



**Shqyrtime rreth nivelit të arsimit dhe punësimit të grave në Kosovë
në dhjetë-vjeçarin e fundit, 2014-2024**

Mentori

Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi

Kandidatja

Arjanita Haradini

Prishtinë, 202

Abstrakt

Ky studim hulumton nivelin e arsimit dhe punësimit të grave në Kosovë gjatë dekadës së fundit (2014–2024), me një fokus të veçantë në mënyrën se si arsimit ndikon në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe në zhvillimin e tyre më të gjerë socio-ekonomik. Duke qenë se gratë përbëjnë gjysmën e shoqërisë, arritja e tyre arsimore nuk ka rëndësi vetëm për fuqizimin individual, por edhe për përparimin kolektiv shoqëror. Gratë e arsimuara kanë tendencë të jenë më të qëndrueshme në jetë, më të artikuluar në kërkesat e tyre dhe më të afta për të siguruar punësim, gjë që rrit pavarësinë e tyre dhe aftësinë për të rritur dhe edukuar brezat e ardhshëm. Siç thekson Dushi (2009), kualifikimi arsimor është një parakusht për pavarësinë reale individuale dhe ekonomike të grave, pa të cilin barazia gjinore nuk mund të arrihet.

Arsimi njihet si një e drejtë themelore e njeriut dhe një faktor kyç për zhvillimin individual dhe shoqëror. Ky studim shqyrton sfondin historik, zhvillimet aktuale dhe sfidat e pranishme që lidhen me arsimimin dhe punësimin e grave në Kosovë. Po ashtu, thekson nevojën për fuqizimin e grave përmes arsimit dhe integritit të tyre në tregun e punës. Megjithatë ka pasur përparime të konsiderueshme në sektorin e arsimit, barrierat kryesore qëndrojnë ende sa i përket përfshirjes në tregun e punës. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore në Kosovë është ndër më të ultat në Evropë. Deri në vitin 2024, vetëm rreth 20–25% e grave në moshë pune janë aktive në tregun e punës (ASK, 2024).

Qëllimi i studimit është të analizojë zhvillimet dhe sfidat në qasjen e grave në arsim dhe pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës gjatë periudhës 2014–2024. Konkretisht, ai vlerëson nivelin e përfundimit të arsimit në nivele të ndryshme, shqyrton shkallën dhe natyrën e punësimit të grave në sektorin publik dhe privat, si dhe identifikon faktorët strukturorë dhe shoqërorë që ndikojnë në këto dinamika. Gjithashtu, studimi vlerëson efektivitetin e politikave shtetërore dhe programeve mbështetëse që synojnë përmirësimin e qasjes së grave në arsim dhe punësim, me qëllim përfundimtar arritjen e barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.

Për të adresuar pyetjet kërkimore, studimi përdor një kombinim të metodave krahasuese, analitike dhe statistikore. Metoda krahasuese shërben për të vlerësuar ndryshimet në kohë dhe për të krahasuar nivelin e arsimit dhe punësimit ndërmjet periudhave të ndryshme. Metoda analitike ndihmon në identifikimin e ndikimit të proceseve demografike në arsimin dhe punësimin e grave. Analiza statistikore bazohet në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, veçanërisht statistikave të arsimit (2014–2024), Anketa e Fuqisë Punëtore dhe burime shtesë akademike. Këto

mjete i mundësojnë studimit të japë një vlerësim të plotë të barrierave dhe mundësive me të cilat përballen gratë në Kosovë.

Në shoqërinë tradicionale kosovare, gratë kanë zënë historikisht një pozitë dytësore, e formuar nga norma të thella kulturore dhe ligje zakonore si Kanuni i Lekë Dukagjinit. Këto norma i kufizonin rolet e grave kryesisht në përgjegjësi shtëpiake, duke nënvlerësuar kontributin e tyre në jetën publike dhe ekonomike (Begolli, 1984; Dushi, 2009). Gjatë dhjetë viteve të fundit, megjithatë, ka pasur përparim të dukshëm. Gratë dhe vajzat po marrin pjesë gjithnjë e më shumë në sistemin arsimor, me rritje të ndjeshme të regjistrimeve në të gjitha nivelet. Arsimi është bërë një mjet i rëndësishëm për fuqizim personal dhe zhvillim profesional.

Megjithë përparimin në arsim, një hendek ende ekziston në përfaqësimin në tregun e punës. Sipas ASK-së (2023), vetëm 24.2% e grave janë të punësuar, ndërsa 75.8% konsiderohen joaktive në tregun e punës. Ky hendek gjinor përbën një pengesë serioze për arritjen e barazisë socio-ekonomike dhe zhvillimit kombëtar. Edhe pse gratë janë të përfaqësuara në mënyrë gjithnjë e më të madhe në arsimin e lartë, ato përballen me pengesa të mëdha gjatë procesit të punësimit, shpesh për shkak të mungesës së meritokracisë, nepotizmit dhe ndikimit politik. Këto sfida ndikojnë në mënyrë disproporcionale gratë dhe kërkojnë mbështetje më të fuqishme institucionale dhe zbatim të politikave të barazisë në mundësi.

Sa i përket fuqizimit ekonomik, gratë e punësuar raportojnë kushte më të mira ekonomike dhe sociale. Rreth 80% e grave të anketuara theksuan se stabiliteti ekonomik ndikon ndjeshëm në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe punësim. Inkurajueshëm, 48% e të anketuarave besojnë se përfshirja e grave në vendimmarrje ka shënuar rritje graduale, ndërsa vetëm 17% mendojnë se nuk ka pasur përmirësim. Për më tepër, 53% e grave besojnë se tani kanë mundësi të barabarta për të mbajtur pozita drejtuese, megjithëse sfidat praktike ende ekzistojnë, veçanërisht për shkak të tregut të kufizuar të punës në Kosovë.

Familja mbetet shtylla kryesore e vlerave shoqërore në Kosovë dhe luan një rol vendimtar në formimin e ndërgjegjes gjinore. Megjithëse ka përparim në rolin e grave në vendimmarrje dhe punësim, nevojitet ndërgjegjësim më i gjerë shoqëror për të promovuar më tej barazinë gjinore. Kjo përfshin jo vetëm edukim dhe vetëdijësim, por edhe zbatim efektiv të ligjeve për barazi gjinore, ligjeve për trashëgimi dhe kuadrit të plotë ligjor (Krasniqi, 2011).

Studimi gjithashtu thekson rëndësinë e përgatitjes së vajzave të reja për karriera në sektorët me rritje të shpejtë si teknologjia dhe inxhinieria. Sipas UNICEF (2023), këta sektorë pritet të

zgjerohen në vitet e ardhshme. Prandaj, programet për orientim në karrierë janë të domosdoshme për të harmonizuar interesat e vajzave me kërkesat e tregut të punës. Promovimi i përfshirjes së grave në STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) mund të ndihmojë në çmontimin e stereotipeve gjinore dhe të gjenerojë përfitime socio-ekonomike afatgjata.

Fuqizimi ekonomik përmirëson qasjen e grave në burime ekonomike si punësimi, shërbimet financiare, prona dhe zhvillimi i aftësive. Pjesëmarrja e grave në ekonomi dhe fuqizimi i tyre janë thelbësor jo vetëm për autonominë e tyre, por edhe për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Me rëndësi, asnjëra nga gratë e punësuarat të anketuara nuk raportoi vështirësi të mëdha ekonomike, gjë që tregon për një lidhje të fortë ndërmjet punësimit dhe përmirësimit të standardeve të jetesës.

Strategjitë qeveritare, si Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2022–2024, synojnë të zvogëlojnë pabarazitë gjinore përmes përshtatjes së shërbimeve të punësimit me nevojat e grave dhe trajtimit të ndarjes gjinore në profesion. Këto strategji gjithashtu synojnë zgjerimin e shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe barazinë gjinore (Agjencia për Barazi Gjinore, 2020–2024).

Në përfundim, megjithëse është bërë përparim i dukshëm në arsimimin dhe punësimin e grave në Kosovë, ende ekzistojnë sfida strukturore, kulturore dhe ekonomike. Adresimi i tyre kërkon vazhdimësi në përpilimin e politikave, përfshirje shoqërore dhe zbatim të ligjeve për mbrojtjen e barazisë. Fuqizimi i grave përmes arsimit dhe punësimit nuk është vetëm çështje drejtësie sociale, por edhe një nxitës i rëndësishëm për zhvillimin dhe mirëqenien kombëtare.

Title: An Overview of the Level of Education and Employment of Women in Kosovo in the Last Decade, 2014–2024

Abstract (in English language)

This research investigates the level of education and employment of women in Kosovo over the past decade (2014–2024), with a particular focus on how education influences women's participation in the labor market and their broader socio-economic development. Given that women constitute half of society, their educational attainment is not only significant for individual empowerment but also for collective social progress. Educated women tend to be more stable in life, articulate in their demands, and better positioned to secure employment, which enhances their independence and ability to raise and educate future generations. As articulated by Dushi (2009), educational qualification is a prerequisite for women's genuine individual and economic independence, without which gender equality remains unachievable.

Education is recognized as a fundamental human right and a powerful driver of both individual and societal development. This study explores the historical background, ongoing developments, and present challenges related to the education and employment of women in Kosovo. It also emphasizes the necessity of empowering women through education and labor force integration. Despite considerable progress in the education sector, major barriers remain in terms of employment and labor force participation. Women's labor force participation rate in Kosovo is among the lowest in Europe. As of 2024, only about 20–25% of working-age women are active in the labor market (ASK, 2024).

The study aims to analyze developments and challenges in women's access to education and labor market participation during the 2014–2024 period. Specifically, it evaluates the level of educational attainment among women at various educational levels, investigates the rate and nature of women's employment in both public and private sectors, and identifies structural and societal factors influencing these dynamics. It also assesses the effectiveness of state policies and support programs aimed at improving women's access to education and employment, ultimately seeking gender equality and sustainable socio-economic development.

To address the research questions, the study employs a combination of comparative, analytical, and statistical methods. The comparative method is used to assess changes over time and compare the level of education and employment between past and present periods. The

analytical method helps identify how demographic processes have impacted women's education and employment. Statistical analysis is based on data from the Kosovo Agency of Statistics, particularly educational statistics (2014–2024), the Labor Force Survey, and additional academic sources. These tools allow the study to provide a comprehensive evaluation of the barriers and opportunities faced by women in Kosovo.

In traditional Kosovar society, women have historically occupied a secondary position, shaped by deep-rooted cultural norms and customary laws like the Kanun of Lekë Dukagjini. These norms limited women's roles primarily to domestic responsibilities, often devaluing their contributions to public and economic life (Begolli, 1984; Dushi, 2009). Over the past ten years, however, there has been notable progress. Women and girls are increasingly participating in the education system, with a significant rise in enrollment across all levels. Education has become a key tool for personal empowerment and career development.

Despite progress in education, a gap persists in labor market representation. According to the Kosovo Agency of Statistics (2023), only 24.2% of women are employed, and 75.8% are considered inactive in the labor market. This gender gap poses a serious obstacle to achieving socio-economic equality and national development. Although women are increasingly represented in higher education, they face considerable barriers during the hiring process, often due to bureaucratic inefficiencies, nepotism, and political influence. These challenges disproportionately affect women, and overcoming them requires stronger institutional support and enforcement of equal opportunity policies.

In terms of economic empowerment, employed women report significantly better economic and social conditions. Approximately 80% of surveyed women noted that economic stability greatly influences their ability to participate in employment and decision-making processes. Encouragingly, 48% of respondents believed that women's involvement in decision-making has increased gradually, while only 17% felt it had not improved. Moreover, 53% of women believe they now have equal opportunities to hold managerial positions as men, although practical challenges still exist, especially given the limited job market in Kosovo.

Family remains the cornerstone of societal values in Kosovo and plays a pivotal role in shaping gender consciousness. Though there has been advancement in women's roles in decision-making and employment, broader societal awareness is needed to further promote gender equality.

This includes not just education and awareness but also effective implementation of gender equality laws, inheritance laws, and other relevant legal frameworks (Krasniqi, 2011).

The study also highlights the importance of preparing young women for careers in high-growth sectors such as technology and engineering. According to UNICEF (2023), these fields are expected to expand in the coming years. Therefore, career guidance programs are essential to align young women's interests with labor market opportunities. Promoting women's participation in STEM (Science, Technology, Engineering, Mathematics) can help dismantle gender stereotypes and generate long-term socio-economic benefits.

Economic empowerment improves women's access to economic resources such as jobs, financial services, property, and skill development. Women's participation in the economy and their empowerment are vital not only for their own autonomy but also for broader societal development. Notably, none of the employed women surveyed reported experiencing severe economic hardship, indicating a strong link between employment and improved living standards.

Government strategies, such as the Sectoral Strategy of the Ministry of Labor and Social Welfare 2022–2024, aim to reduce gender inequalities by tailoring employment services to women's needs and addressing occupational segregation. These strategies also seek to expand social and family services, with a special focus on vulnerable groups and gender equality (Agency for Gender Equality, 2020–2024).

In conclusion, while significant progress has been made in women's education and employment in Kosovo, numerous structural, cultural, and economic challenges persist. Addressing these requires continued policy innovation, societal engagement, and enforcement of legal protections. Women's empowerment through education and employment is not only a matter of social justice but also a critical driver of national development and prosperity.

